REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E MAKROEKONOMISË



# EKONOMIA DHE BUXHETI

*QERSHOR, 2011*

# *Raporti Mujor*

## *Qershor, 2011*

*Kontakt:*
*Telefon: ++355 (4) 228 1009*
*e-mail: elami@minfin.gov.al*

www.minfin.gov.al

# PËRMBAJTJA

VEÇORITË KRYESORE.......................................................................2

ZHVILLIMET EKONOMIKE.................................................................3

1. Indeksi i Çmimeve të Konsumit 3
2. Kursi mesatar i këmbimit 4
3. Ecuria e Normave të Interesit të Depozitave dhe Huave 5
4. Bilanci i Pagesave 6
5. Mjetet Valutore Neto të Sistemit Bankar 7
6. Kredia për Ekonominë 7
7. Oferta e Parasë 8
8. Depozitat sipas Burimeve 9

SEKTORI FISKAL ..........................................................................10

1. Buxheti i Konsoliduar 10
2. Të Ardhurat sipas Burimeve 11
3. Financimi i Bilancit Fiskal 11

ANEKSI STATISTIKOR ....................................................................12

# VEÇORITË KRYESORE

- *Indeksi i çmimeve të konsumit* në muajin Qershor, 2011 arriti në 109.8 përqind
- *Norma vjetore e inflacionit* për muaji Qershor ishte 3.9 përqind
- *Kursi mesatar i këmbimit* të monedhes vendase me dy monedhat kryesore të huaja për muajin Qershor 2011 ishte 98.65 lekë për dollarë dhe 141.97 lekë për euro
- *Normat e interesit të depozitave në lekë* gjatë muajit Qershor shënuan kuotat 6.56 përqind për depozitat 24 mujore, 5.71 për ato 12 mujore, 4.77 për 6 mujorët dhe 4.15 perqind per depozitat 3 mujore
- *Normat e interesit për huatë në lekë* ishin 11.53 përqind për huatë 12 mujore dhe 12.69 për ato 6 mujore
- *Oferta totale e parasë*, e matur nga agregati M3, arriti në 1,008.7 miliardë lekë në muajin Qershor, duke shënuar një rritje prej rreth 11.8 përqind, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë
- *Bilanci i pagesave* për vitin tremujorin e parë 2011 rezultoi me një defiçit të përgjithshëm prej 77.2 milion euro.
- *Situata Buxhetore* për periudhën Janar - Qershor 2011 rezultoi me një defiçit të përgjithshëm prej rreth 26.4 miliardë lekë.
- *Të ardhurat gjithsej* të realizuara gjatë periudhës Janar - Qershor 2011, arritën në rreth 155.3 miliardë lekë, ose rreth 93.2 përqind e planit për periudhën.
- *Shpenzimet gjithësej* gjatë të njëjtës periudhë, arritën në rreth 181.6 miliardë lekë, ose rreth 97.3 përqind e shpenzimeve të planifikuara për periudhën.

# ZHVILLIMET EKONOMIKE

## 1. Indeksi i Çmimeve të Konsumit

Indeksi i Çmimeve të Konsumit (IÇK) për muajin Qershor 2011 pësoi një rënie prej 1.1 përqind krahasuar me muajin Maj dhe Prill ‘11, kur ky indeks shënonte përkatësisht -1.1 përqind dhe -0.6 përqind. Ndryshimet respektive në të njëjtët muaj të një viti më parë ishin -0.7 përqind, -1.2 përqind dhe -0.4 përqind. Rritja me e madhe mujore, gjatë muajit Qershor u konstatua në grupin “Shëndeti” me 0.3 përqind. Pesha specifike relativisht e ulët që zë ky grup në shportën e mallrave të konsumit, bën që ndryshimet e çimimeve për këtë grup të kenë efekte të ulët mbi normën e inflacionit. Gjatë këtij muaji rënie prej -2.6 % e pësoi indeksi i cmimit te grupit “Ushqime dhe pije joalkolike”.

Graf - 1




*Ndryshimet mujore të IÇK-së*

Burimi: INSTAT

Norma vjetore e inflacionit në muajin Qershor arriti në 3.9 përqind duke qëndruar brenda objektivit të Bankës së Shqipërisë. Ndryshimet vjetore të indeksit të çmimeve të konsumit, në përqindje, për vitet 2010 dhe 2011 paraqiten në tabelën 1.

Tab - 1 *Ndryshimi vjetor i Indeksit të Çmimeve të Konsumit (në %)*

| *VITI* | Janar | Shkurt | Mars | Prill | Maj | Qershor |
|---|---|---|---|---|---|---|
| *2010* | 4.1 | 4.4 | 3.9 | 3.5 | 3.1 | 3.2 |
| *2011* | 3.3 | 4.5 | 4.3 | 4.1 | 4.2 | 3.9 |
| *VITI* | Korrik | Gusht | Shtator | Tetor | Nëntor | Dhjetor |
| *2010* | 3.4 | 3.5 | 3.4 | 3.0 | 2.8 | 3.4 |
| *2011* | | | | | | |

*Burimi: INSTAT*

## 2. Kursi mesatar i këmbimit

Kursi mesatar i këmbimit të lekut kundrejt Euros në muajin Qershor 2011, arriti në 141.97 Lekë/Euro, duke shënuar një rritje prej 0.1 përqind krahasuar me një muaj më parë. Në fund të muajit Qershor një euro u këmbye me 141.41 lekë. Kursi mesatar i këmbimit të lekut kundrejt dollarit amerikan në muajin Qershor 2011, arriti në 98.65 lekë/dollarë duke shënuar një rënie prej 0.1 përqind kundrejt muajit Maj '11.

Graf - 2




*Ecuria e Kursit të Këmbimit gjatë muajit Qershor'11*

Në fund të muajit Qershor, dollari amerikan arriti nivelin 97.68 lekë/dollarë. Në krahasim me muajin Qershor të vitit të kaluar rezulton se monedha shqiptare është vlerësuar ndaj dollarit amerikan në masën 11.8 përqind dhe është zhvlersuar kundrejt monedhës europiane, Euro, me 3.9 përqind. Nëncmimi i lekut, kundrejt dy monedhave kryesore, monedhës europiane Euro dhe monedhës amerikane, në rradhë të parë është i lidhur me ecurinë e tyre në tregjet monetare ndërkombëtare, duke reflektuar sjelljen e tyre në tregun e brendshëm monetar. Kursi i këmbimit të euros me dollarin amerikan pësoi një rritje mesatare duke arritur në rreth 1.439 euro/dollarë.

Ndër faktorët e brendshëm që kanë ndikuar në ecurinë e monedhës vendase gjatë këtij muaji përmendim: ruajtjen e ritmeve pozitive të ekonomisë në vend, efikasitet te politkës fiskale, efikasitet në politikën monetare dhe në operacionet ndërbankare të ndërmarra nga Banka e Shqipërisë, etj.

## 3. Ecuria e Normave të Interesit të Depozitave dhe Huave

Gjatë muajit Qershor 2010, normat e interesit të depozitave 12-mujore në lekë arritën kuotën e 5.71 përqind, duke shënuar një rënie prej 0.16 përqind krahasuar me muajin Maj. Rritje për këtë muaj kanë pësuan depozitat me afat 3-mujor dhe 1-mujor të krahasuara me muajin paraardhës, respektivisht me 0.02 dhe 0.76 përqind. Normat e interesit për depozitat me afat 6-mujor pësuan rënie me 0.17 përqind krahasuar me muajin paraardhës. Krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, rënie kanë pësuar normat e interesit të depozitave me afat 12, 6 dhe 3 mujore. Interesi i huave 12-mujore gjatë muajit Qershor pësoi një rritje me 0.35 pikë përqind, duke arritur në 11.53 përqind nga 11.18 përqind që ishte në muajin Maj. Për këtë muaj norma e interesit të huave 6-mujore pësuan një rritje prej 1.52 pikë përqind krahasuar me një muaj më parë. Interesi i huave 6-mujore për muajin Qershor arriti në 12.69 përqind. Normat e interesit të bonove të thesarit gjatë muajit Qershor 2011, për bonot me maturim 12, 6 dhe 3 mujor ishin përkatësisht 7.54 përqind, 6.80 përqind dhe 5.65 përqind. Gjatë këtij muaji vihet re një rritje në Yield-et e bonove të thesarit për afatet e maturimit 12 dhe 3 - mujore.

Graf - 3




*Normat e interesit për depozitat*

Graf - 4




*Normat e interesit për huatë*

# 4. Bilanci i Pagesave

Graf - 5




*Bilanci i Pagesave*

Burimi: Banka e Shqipërisë

Bilanci i pagesave për periudhën Janar – Mars 2011 regjistroi nje defiçit të përgjithshëm prej 77.2 milionë euro, karakteristika strukturore e të cilit paraqitet në grafikun 5.

Graf - 6




*Llogaria Korente*

Burimi: Banka e Shqipërisë

Kompozicioni i defiçitit të llogarisë korente prej 246.3 milion euro i shprehur sipas elementëve kryesorë përbërës (ne terma neto) për periudhën Janar'11 - Mars'11 rezultoi:
*(i)* bilanci tregtar -408.5 mln euro, *(ii)* shërbime neto -46.1 mln euro, *(iii)* të ardhura neto 11.8 mln euro, (iv) transferta neto 196.5 mln euro. Kjo strukturë në mënyrë vizuale paraqitet ne grafikun 6.

## 5. Mjetet Valutore Neto të Sistemit Bankar

Gjatë muajit Qershor 2011, sistemi bankar ka shënuar rënie të mjeteve valutore neto (M.V.N), në rreth 13,192.3 milionë lekë krahasuar me fundvitin 2010. Kjo rënie ka ardhur si pasojë e rënies të mjeteve valutore neto në Bankën e Shqipërisë me rreth 12,624.6 milionë lekë dhe të rënies së mjeteve valutore neto të bankave të nivelit të dytë, me rreth 567.7 milionë lekë. Në muajin Qershor sistemi bankar rezulton me një rritje prej 1,232.0 milionë lekë në mjetet valutore neto, krahasuar me muajin Maj ‘11, rritje e cila erdhi si rezultat i rritjes së nivelit të mjeteve valutore neto të bankave të nivelit të dytë me rreth 3,498.9 milionë lekë si dhe të rënies së mjeteve valutore neto në Bankën e Shqipërisë, me rreth 2,266.9 milionë lekë.

Graf - 7




***Ecuria e M.V.N. te sistemit në Qer'10-Qer'11***

Burimi: Banka e Shqipërisë

## 6. Kredia për Ekonominë

Teprica e kredisë për ekonominë për muajin Qershor 2011 arriti në 510.4 miliardë lekë. Rritja e tepricës së kredisë, krahasuar me muajin Maj‘11 shënoi vlerën 4.5 miliardë lekë, me një rritje prej rreth 0.9 përqind. Nga struktura e tepricës së kredisë sipas monedhave vazhdon të mbizoterohet nga kredia në valutë, duke përbërë rreth 66.4 përqind të totalit të tepricës së kredisë me rreth 339 miliardë lekë.

Këtë muaj pesha specifike e kredive për individët, arriti në nivelin 30.3 përqind.

# 7. Oferta e Parasë

Graf-8




*Agregati M3 Qer '10-Qer '11*

Burimi: Banka e Shqipërisë

Oferta e parasë (e matur me M3), për muajin Qershor ka shënuar një rritje krahasuar me muajin paraardhës Maj 2011. Kjo ofertë arriti në rreth 1,008 miliardë lekë në fund të muajit Qershor duke shënuar një rritje prej 10.2 miliardë lekë kundrejt nivelit të rregjistruar në muajin Maj. Rritja vjetore e këtij treguesi ishte 11.8 përqind, duke ruajtur kështu tendencën rritëse të shfaqur që nga mesi i vitit të kaluar.

Grf-9




***Raporte të parasë jashtë bankave me M3 dhe Depozitat***

Burimi: Banka e Shqipërisë

Depozitat në lekë, si përbërësi kryesor i ofertës monetare, kanë pësuar një rritje prej 4.2 milionë lekë në krahasim me muajin Maj.

Graf-10




***Raporti i Depozitave ndaj M3***

Burimi: Banka e Shqipërisë

Depozitat në valutë gjatë muajit Qershor, janë mbështetur kryesisht nga depozitat e sektorit privat, të cilat kanë përbërë rreth 83.7 përqind të depozitave totale në valutë.

# 8. Depozitat sipas Burimeve

Gjatë muajit Qershor 2011 "sektorë të tjerë rezident", zuri nivelin më të lartë të depozitave të trasferueshme në lekë, me rreth 64.0 përqind, ndjekur nga "korporata të tjera jofinanciare", me rreth 25.2 përqind dhe nga "korporata publike jofinanciare", me 8.4 përqind. "Sektorë të tjerë rezident" dhe "korporata të tjera jofinanciare" ishin gjithashtu burimi më i rëndësishëm i depozitave në monedhe të huaj, përkatësisht me rreth 83.7 përqind dhe rreth 13.1 përqind. "Sektorë të tjerë rezident" ishin dukshëm burimi më i rëndësishëm i Depozitave të tjera në lekë (95.8 përqind e totalit)

Graf - 11




***Përberja e depozitave***

Burimi: Banka e Shqipërisë

Në përgjithësi, "Sektorë të tjerë rezident" përbëjnë pjesën më të madhe (rreth 713 miliarde) të depozitave totale, prej rreth 819.4 miliardë lekë në muajin Qershor 2011. Ata ndiqen nga "korporata të tjera jofinanciare" (79.3 miliardë), "korporatat të tjera jofinanciare publike" (16.1 miliardë) dhe "korporata të tjera financiare" (7.9 miliardë). "Qeveria lokale" kontribuoi me rreth 2.1 miliardë në totalin e depozitave.

Gjatë muajit Qershor 2011, krahasuar me nje muaj më parë Maj '11 niveli i përgjithshëm i depozitave u rrit me 8.8 miliardë lekë, si rezultat i rritjes së depozitave në lekë dhe të atyre në valutë .

# SEKTORI FISKAL

## 1. Buxheti i Konsoliduar

Për periudhën Janar - Qershor 2011 janë mbledhur rreth 155.3 miliardë lekë të ardhura, përkundrejt shpenzimeve të përgjithshme prej 181.6 miliardë lekë, që përfshijnë 149.1 miliardë lekë në shpenzime korrente dhe 32.3 miliardë lekë në shpenzime kapitale, nga të cilat 75 % financim i brëndshëm, dhe 25 % financim i huaj.

Graf - 12




*Treguesit Fiskal, Janar- Qershor 2011*

Mbledhja e të ardhurave përbën rreth 42.9 % të të ardhurave buxhetore për planin e vitit 2011, ndërsa shpenzimet përbëjnë 44.4 % të buxhetit të planifikuar. Shpenzimet korrente janë rreth 46.4 % e planifikimit vjetor, ndërsa shpenzimet kapitale janë rreth 39.1 % e këtij planifikimi.

Nga të ardhurat gjithsej, pjesa e të ardhurave të mbledhura nga Drejtoria e Përgjithshme të Tatimeve dhe Doganave është rreth 108.7 miliardë lekë (ose rreth 30 % e të ardhurave vjetore të planifikuara), të ardhurat e mbledhura nga pushteti vendor rreth 6.8 miliardë lekë (1.9 % e të ardhurave vjetore të planifikuara), kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore 27.7 miliardë lekë (7.7 % e të ardhurave vjetore të planifikuara), dhe të ardhurat jo - tatimore në nivelin e 10.9 miliardë lekë (3 % e të ardhurave vjetore të planifikuara). Nga totali i shpenzimeve korrente prej 149.1 miliardë lekë, 32.9 miliardë lekë (22.1 % e totalit të shpenzimeve korrente) është shpenzuar për personelin, 19.6 miliardë lekë (13.1 %) për interesat, 16 miliardë lekë (10.7 %) për shpenzime operative dhe mirëmbajtje, 2.4 miliardë lekë (1.6 %) për subvencione, 54 miliardë lekë (36.2 %) për shpenzimet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetsore dhe 14.7 miliardë lekë (9.9 %) për shpenzimet e qeverisjes vendore, 9.6 miliardë lekë (6.5 %) për shpenzimet e tjera. Këto përfaqësojnë 8.1 % (shpenzime personeli), 4.8 % (shpenzime për interesat), 3.9 % (shpenzime operative dhe të mirëmbajtjes), 0.6 % (subvencione), 13.2 % (sigurimet shoqërore dhe shëndetësore), 3.6 % dhe 2.4 % (për shpenzimet e qeverisjes vendore dhe shpenzimet e tjera) përkundrejt buxhetit të planifikuar vjetor. Shpenzimet kapitale me financim të brëndshëm për këtë periudhë llogariten në rreth 5.9 % të buxhetit të parashikuar vjetor, ndërsa financimi i huaj është vetëm 2 %.

## 2. Të Ardhurat sipas Burimeve

Të ardhurat gjithsej të realizuara për periudhën Janar - Qershor 2011 ishin rreth 155.3 miliardë lekë, nga të cilat të ardhurat tatimore rreth 143.2 miliardë, të ardhurat jo - tatimore në rreth 10.9 miliardë.

Tab - 2 *Të ardhurat e realizuara në Janar - Qershor 2011*

| Burimi | Miliardë Lekë |
|---|---|
| TVSH | 54 |
| Tatimi mbi fitimin | 11.3 |
| Taksa doganore | 3.3 |
| Taksat nacionale | 9.6 |
| Akcizat | 17.2 |

## 3. Financimi i Bilancit Fiskal

Defiçiti prej 26.4 miliardë lekë, për periudhën Janar - Qershor 2011, u mbështet në vlerën 24.2 miliardë lekë nga burime të brëndshme dhe 8.1 miliardë lekë me financim të huaj. Emetimi i bonove të thesarit ishte mjeti kryesor i financimit të brëndshëm, ndërsa për financimin e huaj ishin huatë afatgjata.

Për periudhën Janar - Qershor 2011, disa nga treguesit kryesorë fiskal ishin:

- Realizimi i Të Ardhurave në masën 155.3 miliardë lekë.
- Realizimi i Shpenzimeve në masën 181.6 miliardë lekë

Në realizimin e të ardhurave për këtë periudhe kontributin kryesorë e kanë dhënë të ardhurat e mbledhura nga Tatimet dhe Doganat të cilat kapin shifrën e 108.7 miliardë lekë. Në realizimin e shpenzimeve për këtë periudhë, peshën me të lartë e zënë shpenzimet korrente me 149.1 miliardë lekë dhe shpenzimet kapitale me rreth 32.3 miliardë lekë.

# Aneksi Statistikor

Tab - 1

| | Mujor (Monthly ) | | | | | Mesatar Mujor (Monthly Average) | | | | | Vjetor (Annual) | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Muaji | 2007 | 2008 | 2009 | 2010 | **2011** | 2007 | 2008 | 2009 | 2010 | **2011** | 2007 | 2008 | 2009 | 2010 | **2011** | Month |
| Janar | 0.5 | 0.5 | 0.4 | 0.9 | 0.8 | 0.50 | 0.50 | 0.40 | 1.00 | 0.80 | 2.9 | 3.0 | 2.1 | 3.6 | 3.3 | January |
| Shkurt | 0.5 | 1.0 | 0.7 | 1.1 | 2.3 | 0.50 | 0.75 | 0.55 | 1.02 | 1.55 | 2.9 | 3.6 | 1.9 | 4.7 | 4.5 | February |
| Mars | -0.1 | 0.9 | 0.6 | 0.1 | -0.1 | 0.30 | 0.80 | 0.57 | 0.71 | 1.00 | 2.7 | 4.6 | 1.6 | 4.1 | 4.3 | March |
| Prill | -0.2 | -0.4 | -0.1 | -0.4 | -0.6 | 0.18 | 0.50 | 0.40 | 0.42 | 0.60 | 1.9 | 4.4 | 1.9 | 3.7 | 4.1 | April |
| Maj | -0.8 | -1.0 | -0.8 | -1.2 | -1.1 | -0.02 | 0.20 | 0.16 | 0.10 | 0.26 | 1.4 | 4.2 | 2.1 | 3.3 | 4.2 | May |
| Qershor | -0.6 | -0.8 | -0.6 | -0.7 | -1.1 | -0.12 | 0.03 | 0.03 | -0.04 | 0.03 | 2.0 | 4.0 | 2.3 | 3.2 | 3.9 | June |
| Korik | -0.3 | -0.6 | -0.7 | -0.5 | | -0.14 | -0.06 | -0.07 | -0.10 | | 2.1 | 3.7 | 2.2 | 3.4 | | July |
| Gusht | 1.9 | 0.6 | 0.7 | 0.8 | | 0.11 | 0.03 | 0.03 | 0.01 | | 4.2 | 2.5 | 2.2 | 3.5 | | August |
| Shtator | 0.9 | 1.1 | 0.8 | 0.7 | | 0.20 | 0.14 | 0.11 | 0.09 | | 4.4 | 2.7 | 2.0 | 3.4 | | September |
| Tetor | -0.1 | 0.1 | 0.4 | 0.2 | | 0.17 | 0.14 | 0.14 | 0.10 | | 4.2 | 2.8 | 2.3 | 3.0 | | October |
| Nendor | 0.2 | -0.1 | 0.4 | 0.2 | | 0.17 | 0.12 | 0.16 | 0.11 | | 3.5 | 2.6 | 2.8 | 2.8 | | November |
| Dhjetor | 1.3 | 0.9 | 1.6 | 2.2 | | 0.27 | 0.18 | 0.28 | 0.28 | | 3.1 | 2.2 | 3.7 | 3.4 | | December |

*Burimi: INSTAT, Banka e Shqipërisë* *Source : INSTAT,Bank of Albania*

Tab - 2 **Kursi i kembimit**
Exchange rate

Leke per njesi te monedhes se huaj *(Leke per unit of foreign currency)*

| Monedha | 2007 | 2008 | 2009 | 2010 | 2011 Jan | Feb | Mar | Apr | May | Jun | Currency |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| *Mesatarja e periudhes* | | | | | | | | | | | *Average of period* |
| USD | 90.43 | 83.89 | 94.98 | 103.94 | 103.84 | 102.27 | 100.17 | 97.89 | 98.79 | 98.65 | USD |
| EURO | 123.63 | 122.80 | 132.06 | 137.79 | 138.65 | 139.59 | 140.14 | 141.48 | 141.80 | 141.97 | EURO |
| *Fundi i periudhes* | | | | | | | | | | | *In the end of period* |
| USD | 82.89 | 87.91 | 95.81 | 104.00 | 102.16 | 101.25 | 99.04 | 95.90 | 98.58 | 97.68 | USD |
| EURO | 121.78 | 123.80 | 137.96 | 138.77 | 139.31 | 139.92 | 140.57 | 142.40 | 142.10 | 141.41 | EURO |

*Burimi : Banka e Shqiperise* *Source : Bank of Albania*

Tab - 3

**Normat e interesit me baze vjetore**

Annual Interest Rates

| | | | | | 2011 | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Ne perqindje | | | | | Janar | Shkurt | Mars | Prill | Maj | Qershor | In percent |
| **Norma e depozitave** | | | | | | | | | | | **Deposits rates** |
| 12-M | 5.67 | 6.93 | 6.78 | 6.07 | 5.98 | 5.89 | 5.80 | 5.90 | 5.87 | 5.71 | 12-M |
| 6-M | 4.83 | 5.72 | 5.74 | 5.16 | 5.10 | 4.86 | 4.82 | 4.83 | 4.94 | 4.77 | 6-M |
| 3-M | 4.12 | 5.13 | 5.05 | 4.42 | 4.21 | 4.25 | 4.14 | 4.21 | 4.13 | 4.15 | 3-M |
| 1-M | 3.83 | 4.30 | 4.56 | 4.70 | 4.66 | 4.59 | 3.53 | 3.71 | 4.02 | 4.78 | 1-M |
| **Norma e huase** | | | | | | | | | | | **Lending rates** |
| 12-M | 11.73 | 11.75 | 12.46 | 11.52 | 11.70 | 11.52 | 11.81 | 11.68 | 11.18 | 11.53 | 12-M |
| 6-M | 14.11 | 12.85 | 12.54 | 11.69 | 14.04 | 21.22 | 11.18 | 11.69 | 11.17 | 12.69 | 6-M |
| **Norma e letrave me vlere** | | | | | | | | | | | **Securities rates** |
| Bono thesari 1/ | | | | | | | | | | | Treasury bills 1/ |
| 3-M | 6.48 | 6.27 | 6.30 | 5.29 | ... | 5.21 | 5.35 | ... | 5.47 | 5.65 | 3-M |
| 6-M | 7.51 | 7.45 | 7.52 | 6.41 | 6.32 | 6.38 | 6.72 | 6.84 | 6.82 | 6.80 | 6-M |
| 12-M | 8.41 | 8.56 | 9.14 | 7.09 | 6.83 | 6.95 | 7.27 | 7.41 | 7.36 | 7.54 | 12-M |

*Burimi : Banka e Shqiperise*

*Source : Bank of Albania*

Tab - 4 **TREGUESIT FISKALE SIPAS BUXHETIT TE KONSOLIDUAR 2011**
Fiscal indicators regarding consolidated budget of 2011

*Te dhena progresive (Progresive Data)* *ne milion leke (in million leks)*

| Nr. | E M E R T I M I | Janar January | Shkurt Feb | Mars Mar | Prill Apr | Maj May | Qershor Jun | ITEM | No. |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | **TOTALI TE ARDHURAVE** | **27,006** | **49,144** | **77,535** | **103,665** | **130,132** | **155,247** | **TOTAL REVENUE** | |
| I. | **Ndihma** | **7** | **202** | **454** | **589** | **865** | **1,120** | **Grants** | I. |
| II. | **Te ardhura tatimore** | **23,520** | **44,405** | **70,143** | **94,621** | **119,333** | **143,204** | **Tax Revenue** | II. |
| II.1 | **Nga Tatimet dhe Doganat** | **17,116** | **33,081** | **53,294** | **70,388** | **89,506** | **108,701** | **From tax offices and customs** | II.1 |
| 1 | Tatimi mbi Vleren e Shtuar | 8,750 | 17,032 | 26,278 | 34,860 | 44,175 | 53,974 | V. A. T | 1 |
| 2 | Tatimi mbi Fitimin | 1,302 | 2,415 | 6,388 | 7,707 | 9,996 | 11,312 | Profit Tax | 2 |
| 3 | Akcizat | 2,451 | 4,830 | 7,409 | 10,321 | 13,390 | 17,187 | Excise Tax | 3 |
| 4 | Tatimi mbi te Ardhurat Personale | 2,456 | 4,595 | 6,817 | 8,989 | 11,240 | 13,364 | Personal Income Tax | 4 |
| 5 | Taksa Nacionale dhe te tjera | 1,614 | 3,189 | 4,783 | 6,357 | 7,988 | 9,556 | National Taxes and others | 5 |
| 6 | Taksa Doganore | 543 | 1,020 | 1,619 | 2,154 | 2,717 | 3,308 | Custom Duties | 6 |
| II.2 | **Te ardhura nga Pushteti Lokal** | **851** | **1,512** | **2,788** | **4,880** | **6,282** | **6,765** | **Revenues from Local Gov.** | II.2 |
| 1 | Tatimi mbi pasurine | 83 | 213 | 457 | 877 | 958 | 1,043 | Tax on land | 1 |
| 2 | Tatimi mbi Biznesin e vogel | 312 | 352 | 441 | 961 | 1,737 | 1,797 | Small Business Tax | 2 |
| 3 | Taksa lokale | 456 | 947 | 1,890 | 3,042 | 3,587 | 3,925 | Local Taxes | 3 |
| II.3 | **Te ardh Buxh. Pavarur** | **5,553** | **9,812** | **14,061** | **19,353** | **23,545** | **27,738** | **Social ins** | II.3 |
| 1 | Sigurimi Shoqeror | 4,745 | 8,349 | 12,179 | 16,943 | 20,645 | 24,161 | Social Insurance | 1 |
| 2 | Sigurimi Shendetsor | 587 | 1,121 | 1,355 | 1,713 | 2,085 | 2,642 | Health insurance | 2 |
| 3 | Te ardhura per kompensim ne vlere te pronareve | 221 | 342 | 527 | 697 | 815 | 935 | | |
| III. | **Te ardhura Jotatimore** | **3,479** | **4,537** | **6,938** | **8,455** | **9,934** | **10,923** | **Nontax Revenue** | III. |
| 1 | Tran.Fitimi nga Banka e Shqiperise | 1,500 | 1,500 | 3,010 | 3,210 | 3,360 | 3,560 | Profit transfer from BOA | 1 |
| 2 | Te ardhura nga Inst.Buxhetore | 1,573 | 2,259 | 2,909 | 3,434 | 3,968 | 4,414 | Income of budgetary institutions | 2 |
| 6 | Dividenti | 0 | 0 | 1 | 1 | 327 | 332 | Divident | 4 |
| 7 | Tarifa sherbimesh | 129 | 411 | 573 | 1,228 | 1,518 | 1,741 | Services | 5 |
| 8 | Te tjera dhe interesa | 277 | 367 | 445 | 582 | 761 | 876 | Other/not allocated | 6 |
| | **TOTALI I SHPENZIMEVE** | **25,385** | **58,048** | **89,311** | **119,575** | **150,538** | **181,609** | **TOTAL EXPENDITURE** | I. |
| I. | **Shpenzime Korrente** | **19,375** | **43,874** | **69,672** | **94,590** | **122,123** | **149,114** | **Current Expenditures** | I.1 |
| I.1 | **Personeli** | **5,359** | **10,799** | **16,157** | **21,794** | **27,312** | **32,940** | **Personnel expenditures** | 1 |
| 1 | Paga | 4,621 | 9,304 | 13,923 | 18,797 | 23,586 | 28,462 | Wages | 2 |
| 2 | Kontributi per Sigurime Shoqerore | 738 | 1,495 | 2,234 | 2,997 | 3,726 | 4,478 | Social insurance contributions | 3 |
| 3 | Politikat e reja pagash | | | | | | | Of which; Contingency | |
| I.2 | **Interesat** | **2,433** | **6,673** | **9,480** | **11,395** | **15,095** | **19,552** | **Interest** | I.2 |
| 1 | Te Brendshme | 2,212 | 6,138 | 8,787 | 10,420 | 13,712 | 17,830 | Domestic | 1 |
| 2 | Te Huaja | 221 | 535 | 693 | 975 | 1,383 | 1,722 | Foreign | 2 |
| I.3 | **Shpenzime Operative Mirembajtje** | **1,743** | **3,825** | **7,055** | **10,000** | **13,085** | **16,001** | **Operational & Maintenance** | I.3 |
| I.4 | **Subvencionet** | **41** | **155** | **258** | **699** | **2,165** | **2,372** | **Subsidies** | I.4 |
| | | | | | | | | | I.5 |
| I.5 | **Shpenzime per Sig.Sociale dhe te tjera** | **7,608** | **16,777** | **25,770** | **34,866** | **44,365** | **53,929** | **Social insurance outlays** | 1.5 |
| 1 | Sigurime Shoqerore | 6,088 | 12,406 | 19,198 | 26,063 | 32,850 | 40,134 | Social insurance | 1 |
| 2 | Sigurime Shendetsore | 1,520 | 4,021 | 6,222 | 8,453 | 10,610 | 12,890 | Health insurance | 2 |
| 3 | Shpenzime per kompensime ne vler te pronarve | | 350 | 350 | 350 | 905 | 905 | | |
| I.6 | **Shpenzime per Buxhetin Lokal** | **1,304** | **3,306** | **6,575** | **9,788** | **12,299** | **14,684** | **Local Budget** | I.6 |
| I.7 | **Shpenzime te tjera** | **887** | **2,339** | **4,377** | **6,048** | **7,802** | **9,636** | **Other expenditures** | I.7 |
| 1 | Pagesa e Papunesise | 81 | 149 | 225 | 293 | 358 | 425 | Unemployment insurance benefits | 1 |
| 2 | Ndihma Ekonomike | 806 | 2,190 | 3,752 | 5,355 | 6,544 | 7,811 | Social assistance | 2 |
| 3 | Kompensim per ish te perndjekurit politike | | | 400 | 400 | 900 | 1,400 | Compensation for ex political prisoners | 3 |
| I.8 | **Trensferime kapitale per llog speciale te shpronsimeve** | | | | **200** | 200 | 200 | **Property Compensation** | I.8 |
| II. | **Fondi Rezerve** | | | | | | | **Reserve fund/contigency** | II. |
| III. | **Shpenzime Kapitale** | **6,010** | **14,174** | **19,639** | **24,785** | **28,215** | **32,295** | **Capital expenditures** | III. |
| 1 | Financimi Brendshem | 5,989 | 12,788 | 16,800 | 20,821 | 22,675 | 24,171 | Domestically financing | 1 |
| 2 | Financimi Huaj | 21 | 1,386 | 2,839 | 3,964 | 5,540 | 8,124 | Foreign financed | 2 |
| IV | **DEFIÇITI** | **1,621** | **-8,904** | **-11,776** | **-15,910** | **-20,406** | **-26,362** | **Deficit** | IV |
| IV.1 | **FINANCIMI DEFIÇITIT** | **-1,621** | **8,904** | **11,776** | **15,910** | **20,406** | **26,362** | **Deficit Financing** | IV.1 |
| IV.2 | **Brendshem** | -1,097 | 8,536 | **10,369** | **13,961** | **17,881** | **22,810** | **Domestic** | IV.2 |
| | Te ardhura nga privatizimi | 6 | 47 | 125 | 141 | 162 | 229 | Privatization receipts | |
| | Hua-marrje e brendeshme | 8,097 | 13,376 | 18,225 | 18,937 | 21,743 | 28,880 | Domestic Borrowing | |
| | Huamarje e brendshme nacionale nga te cilat: | 8,098 | 13,359 | 18,182 | 18,880 | 21,687 | 28,825 | | |
| | *EuroBono* | | | | | | | **Euro-Bono** | |
| | *Eurobondi emetime* | | | 4,000 | | | | Alpha bank | |
| | *Ripagesa e kredise tregtare* | | | 0 | | | | Directly from BoA | |
| | Huamarje e brendshme vendori | -1 | 17 | 43 | 57 | 56 | 55 | | |
| | Te tjera nga të cilat: | -9,200 | -4,887 | -7,981 | -5,117 | -4,024 | -6,299 | Other | |
| | Depozite e Qeverise ne Banken e Shqiperise | -3,075 | -3,193 | -1,623 | -4,696 | -4,779 | -5,645 | Government deposit at the BoA | |
| | Te tjera | -6,125 | -1,694 | -6,357 | -423 | 756 | -658 | | |
| | Depozite e Sig.Shoqerore dhe Shendetesore | -3,097 | -2,349 | -1,885 | -1,142 | -2,560 | -2,232 | Health and Social Security Deposit | |
| | Mjete ne ruajtje | 1,645 | 1,639 | 1,617 | 1,840 | 1,839 | 1,560 | | |
| | Principali i nenhuase (Bashkia Tirane=47.3 mln leke) | 127 | 181 | 261 | 455 | 538 | 842 | The amount of the Loan | |
| | Detyrim ndaj ISSH | -19 | 886 | 1,684 | 3,116 | 1,970 | 2,145 | Debt toward H&S Security | |
| | Te tjera (detyrime te perkohshme) | -4,781 | -2,051 | -8,034 | -4,692 | -1,031 | -2,973 | Other (temporary debts) | |
| | **I Huaj** | **-524** | **368** | **1,407** | **1,949** | **2,525** | **3,552** | **Foreign** | |
| | Hua afatgjate(e marre) | 310 | 1,003 | 3,076 | 3,559 | 5,039 | 7,751 | Long-term Loan(Drawings) | |
| | *nga e cila nenhua* | | | 182 | 388 | 461 | 1,268 | | |
| | Ndryshimi i gjendjes se arkes* | -286 | 190 | -680 | -144 | -353 | -758 | Chang. of stat. Account* | |
| | Ripagesat | -548 | -825 | -989 | -1,466 | -2,161 | -3,441 | Repayments | |

* *"Ndryshimi i gjendjes se arkes" perfaqeson ndryshimin ne Depozites se Financimeve te Huaja*

*"Chang. of stat. Account" stands for the change in Foreign Financing Deposit*

*Te dhena operative* *preliminary data*

Tab - 5

**Tabela e investimeve 2011**

Table of investments 2011

*Te dhena progresive (Progresive Data)* *ne milion leke( in million leks)*

| | Janar January | Shkurt Feb | Mars Mar | Prill Apr | Maj May | Qershor Jun | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Financim i brendshem | 5,989 | 12,788 | 16,800 | 20,821 | 22,675 | 24,171 | Domestic financing |
| *Ne %* | *99.65* | *90.22* | *85.54* | *84.01* | *80.37* | *74.84* | *In %* |
| Financim i huaj | 21 | 1,386 | 2,839 | 3,964 | 5,540 | 8,124 | Foreign financing |
| *Ne %* | *0.35* | *9.78* | *14.46* | *15.99* | *19.63* | *25.16* | *In %* |
| Totali | 6,010 | 14,174 | 19,639 | 24,785 | 28,215 | 32,295 | Total |
| *Ne %* | *100* | *100* | *100* | *100* | *100* | *100* | *In %* |

Tab - 6 **TE ARDHURAT NGA ZYRAT E DOGANAVE 2011**
**REVENUES FROM CUSTOMS OFFICE 2011**

*Te dhena progresive (Progresive Data)* *ne milion leke( in million leks)*

| | Janar<br>January | Shkurt<br>Feb | Mars<br>Mar | Prill<br>April | Maj<br>May | Qershor<br>June | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Takse doganore | 543 | 1,020 | 1,619 | 2,154 | 2,717 | 3,308 | Customs Duties |
| TVSH | 5,851 | 11,917 | 19,182 | 26,287 | 33,674 | 41,662 | V.A.T |
| Akcize | 1,411 | 2,726 | 4,192 | 5,722 | 7,356 | 9,631 | Excises |
| Te tjera | 270 | 594 | 771 | 987 | 1,320 | 1,600 | Others |
